



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 2696

Prishtinë, Dt. 29/08/2015

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji/ Biologji MSc
Projektpropozimi	"Krijimi i modelit cuprizonë të sklerozës multiple dhe efekti i trajtimit me metforminë në minjtë Swiss albino ( <i>Mus musculus</i> )"
Kandidatja	Xheneta Mehmeti
Mentori	Prof.Ass.Dr. Ilir Mazreku
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: Vendimi nr.:
Vlerësimi i dorëshkrimit Në temën e shkruar, kandidatja përshkruan dizajnin eksperimental dhe në mënyrë korrekte formulon konceptin e shtruar për hulumtim. Tema e Masterit përmban: -Tetë (8) kapituj që janë të parashikuar edhe në modelin e temës së masterit në faqen e universitetit. -Në kapitullin <b>HYRJE</b> , kandidatja ofron një përshkrim të përgjithshëm të sklerozës multiple, duke e vendosur theksin te modeli i demielinizimit të induktuar nga cuprizonë, potencialin neuroprotektiv të metforminës, si dhe rolin e mikroglisë dhe astrociveve në këtë sëmundje. -Në kapitullin <b>QËLLIMI</b> , kandidatja përshkruan saktë dhe në detaje qëllimin dhe objektivat e hulumtimit. -Në kapitullin <b>MATERIALI DHE METODAT E PUNËS</b> , kandidatja përshkruan të gjitha materialet e përdorura në hulumtim. Njëkohësisht, ajo përshkruan metodologjinë e trajtimit të	

kafshëve laboratorike, mënyrën e administrimit të substancave, testet e përdorura për vlerësimin e sjelljes dhe matjen e parametrave hematologjikë.

Në kapitullin **REZULTATET E HULUMTIMIT**, kandidatja ka paraqitur rezultatet e fituara përmes tabelave dhe grafikonave, duke komentuar secilën prej tyre dhe duke bërë krahasim statistikor ndërmjet grupeve eksperimentale dhe grupit kontroll.

Në kapitullin **DISKUTIMI**, kandidatja përshkruan dallimet dhe ngjajshmëritë e rezultateve të saj dhe të autorëve të tjerë në kontekst të modelit cuprizone të sklerozës multiple, në aspektin e sjelljes së minjve të trajtuar me substancat e caktuara, si dhe ndikimin e mundshëm në parametrat hematologjikë.

E gjithë tema përfundon me konkluzionet e nxjerruara:

- Doza 2.5g/kg e CPZ është e mjaftueshme për të induktuar ndryshime demielinizuese karakteristike për sklerozën e shumëfishtë (SM), në modelin eksperimental të përdorur.
- Doza 50mg/kg e MET është e mjaftueshme për të përmirësuar deficitet motorike dhe njohëse, të shkaktuara si rezultat i administrimit të cuprizone.
- Ndërsa, trajtimi me metforminë ka treguar efekt pozitiv në përmirësimin e deficiteve motorike dhe njohëse të shkaktuara nga cuprizone, administrimi i sheqerit ka rezultuar në përmirësim edhe më të theksuar, duke sugjeruar një rol potencialisht të fuqishëm të saj në rikuperimin e funksioneve neurologjike.
- Duke qenë se metformina ka efekt imunomodulues duke shtypur shumë përgjigje të sistemit imunitar, ne kemi gjetur një ulje të numrit të përgjithshëm të qelizave të bardha të gjakut (WBC) në grupin MET krahasuar me grupin kontroll, me një domethënie statistikore  $p < 0.05$ .

### III. Përfundimi dhe propozimi

Bazuar në atë që u tha me lartë konkludoj se tema Master **“Krijimi i modelit cuprizone të sklerozës multiple dhe efekti i trajtimit me metforminë në minjtë Swiss albino (*Mus musculus*)”**, i kandidatës **Xheneta Mehmeti**, është një punim i mirëfilltë kërkimor-shkencor dhe pritet të jap një kontribut modest në fushën e neurobiologjisë, andaj i propozojmë KMSH të Departamentit të Biologjisë dhe të FSHMN-së të:

- propozojmë që të lëshohet vendimi për mbrojtje të temës të kandidatës **Xheneta Mehmeti**

Prishtinë, \_\_\_\_\_


Komisioni:

1.  \_\_\_\_\_

Prof.Dr. Kemajl Bislimi – anëtar/

2.  \_\_\_\_\_

Prof. Ass. Dr. Ilir Mazreku – anëtar/mentor

3.  \_\_\_\_\_

Prof.Dr. Avni Berisha – anëtar/